

Nr. 18/2 Prot., Dt. 28.04.2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 327/18 Prot.

Tiranë, më 22.4. 2016

**Drejtuar: Znj. DORINA ÇINARI, DREJTORE**

**SEKRETARIATI NISMA PËR TRANSPARENÇË  
NË INDUSTRIJË NXJERRËSE ( EITI )**

**TIRANË**

Lënda: Për përfundimet e auditimit.

E Nderuar Znj. Çinari !

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë ka zhvilluar një mision auditimi në EITI Tiranë, mbështetur në shkresën nr. 327 prot, datë 13.01.2016, për vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi mëparshëm me nr. 1144/6 prot, datë 13.05.2015 dhe ndërmarrja e veprimeve për realizimin e tyre nga ana Juaj.

Grupi i auditimit ka konstatuar se :

Nga auditimi i mëparshëm janë lënë 2 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brëndshëm, nga të cilat një rekomandim është realizuar dhe një nuk është realizuar.

Problematika e rekomandimit të pa zbatuar ka të bëjë me mos përgatitjen e bilancit të konsoliduar të institucionit për vitin 2014.

Në përfundim, Drejtoria e Auditimit të Brëndshëm del në konkluzionin se EITI, Tiranë, nuk ka marrë masa të plota për realizimin e rekomandimeve të auditimit duke moszbatuar plotësisht kërkesat e Urdhërit të Kryeministrit Nr. 70 date 18.04.2006 "Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm ... në Këshillin e Ministrave, në Institucionet në varësi të Kryeministrit a të Ministrave", si dhe akte të tjera nënligjore, vendime e urdhëresa në fuqi.

Bazuar në gjetjet e konstatuara, për përmirësimin e punës në të ardhmen, mbështetur në kërkesat e gjermës "e" të nenit 16 të Ligjit nr. 114/2015 "Për Auditimin e Brëndshëm në Sektorin Publik", në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe aktet e tjera nënligjore që lidhen me auditimin e brëndshëm të miratuara nga Ministri i Financave;

**Urdhëroj :**

1. Të merren masa për përmirësimin e punës në sistemin e kontabilitetit dhe në veçanti në përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 dhe nr. 26, datë 27.12.2007, “ Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, vendore dhe njësitë që varen prej tyre, si dhe të njëjstëve të zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, ndryshuar me udhëzimin nr. 10, datë 27.2.2008.

Në zbatim të gërmës “d” të nenit 12 të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Titullari i institucionit të marrë masa të plota për zbatimin e rekomandimit sipas kësaj shkrese, me afat me përfundimin e pasqyrave financiare të vitit 2015.

Drejtorja e EITI të njoftojë me shkrim DAB mbi realizimin e rekomandimit sipas afatit të përcaktuar më sipër.

**MINISTRI**

**DAMIAN GJIKNORI**

